

VENDIM
Nr. 183, datë 23.11.2016

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË
“EURON ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE
ALBANIA” SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 7, 9 dhe nenit 10 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k. nëpërmjet “Kontratë kredie bankare”, me nr. 2324 rep. dhe nr. 1300 kol., datë 20.6.2016, ka lënë peng disa nga asetet e saj pranë “Raiffeissen Bank”;
- Nëpërmjet “Deklaratë noteriale” me nr. 4176 Rep., nr. 2387 kol., datë 22.9.2016 dhe nr. 4175 rep., nr. 2386 kol., datë 22.9.2016, “Raiffeissen Bank” sh.a., heq dorë nga pengu i vendosur në “Kontratën e Kredisë Bankare” të mësipërme;
- Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k. ka aplikuar pranë ERE-s për të miratuar lënien peng të aseteve pranë Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.;
- Aplikimi i Shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

Neni 7, pika 1, germat: “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licencuar); “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen); “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit); “j” (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., për lënie peng të aseteve sipas listës bashkëlidhur, në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**LISTA PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË “EURON ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË
BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SHA MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 183, DATË 23.11.2016, TË
BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)**

HEC “Bele 1”, me fuqi 5000 KW:

1. Turbinë Frensis copë 2,
2. Gjenerator sinkron copë 2,
3. Valvol butterfly copë 2,
4. Bazament për gjenerator sinkron copë 2,
5. Sistem hidraulik dhe lubrifikues fuqie copë 2,
6. Transformator fuqie copë 2,
7. Qark 20 kV copë 2,
8. Qark 6 kV copë 2,
9. Qark automatizimi copë 2,
10. Sisteme tub & komponent dhe sensor copë 2,
11. Sisteme lubrifikimi fillestar copë 2,
12. Tubacione 1813 m.

HEC “Topojan 2”, me fuqi 4800 KW

1. Turbinë Pelton copë 2,
2. Gjenerator sinkron copë 2,
3. Valvol butterfly copë 2,
4. Bazament për gjenerator sinkron copë 2,
5. Sistem hidraulik dhe lubrifikues fuqie copë 2,
6. Transformator fuqie copë 2,
7. Qark 20 kV copë 2,
8. Qark 6 kV copë 2,
9. Qark automatizimi copë 2,
10. Sisteme tub & komponent dhe sensor copë 2,
11. Sisteme lubrifikimi fillestar copë 2,
12. Tubacione 2985 m..

N/st 20/110 kV

1. Transformator tensioni copë 2,
2. Konservues vaji copë 2,
3. Radiatorë me komponentët copë 2,
4. Depozita vaji copë 2,
5. Panele për transformatorët copë 2,
6. Mbrojtës mbitensioni copë 2,
7. Sisteme shtesë tap chenger copë 2,
8. Sewt shtesë compass për transformatorë copë 2,
9. Sisteme tokëzimi disconnecter copë 2.